# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-471366**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Mbrëmja tragjike në Fushë-Krujë, aksidenti i mori jetën Laertit 19-vjeçar |
| ADRESA | `https://joq-albania.com/artikull/1394280.html` |
| BURIMI | joq-albania.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 26 shtator 2026, 12:10:17 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 26 shtator 2026, 11:59:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 26 shtator 2026, 11:58:00 UTC → 26 shtator 2026, 12:00:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `2fb2ff7598c72114c65d59dfc810709b7eaf446e8251721cd2ef0ea24f34bba4` |
| TEKSTI | `03a3ee446a8125ac7aff53375a4aa785511f31c855abcdb55f41c75f20a33332` |
| PAMJA | `390757082cd7ee583fb1c91b6d287b0a693dcd79f2cdd72380e251c88bff23b8` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `02614852f493db05748240d58829deb2704e36abfd34f931a8ba4ea33f346374` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `0248b36ffa7147e2cf97c5d4334b4ac10f1e643fb19828b3303283d4e0ef69ec` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/02614852f493db05748240d58829deb2704e36abfd34f931a8ba4ea33f346374`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Mbrëmja tragjike në Fushë-Krujë, aksidenti i mori jetën Laertit 19-vjeçar

Shkruar nga: I Cani | Publikuar më: 26.09.2026, 13:59

Share Share



Një aksident i rëndë i regjistruar mbrëmjen e djeshme në Fushë-Krujë i mori jetën një 19-vjeçari dhe la të plagosur dy persona të tjerë.

Ngjarja ndodhi rreth orës 21:15, në vendin e quajtur "Kameras", ku u përplasën tre automjete. Viktima është identifikuar si Laert Zalla, 19 vjeç, i cili ndodhej si pasagjer në njërin prej automjeteve.

I riu u transportua me urgjencë drejt Spitalit të Traumës, por fatkeqësisht mbërriti pa shenja jete.

Laerti ishte student në Forcat e Armatosura, një 19-vjeçar që kishte nisur rrugëtimin e tij në një prej institucioneve më të rëndësishme të vendit. Jeta e tij u ndërpre tragjikisht mbrëmjen e djeshme, në një aksident që tashmë ka lënë pas dhimbje dhe pikëpyetje për familjarët e tij.

Nga përplasja mbetën të plagosur edhe Blerim Durmo, 35 vjeç, dhe Enjo Shijaku, 18 vjeç. Të dy po marrin trajtim në Spitalin e Traumës dhe, sipas të dhënave paraprake, ndodhen jashtë rrezikut për jetën.

Dyshimet e para lidhen me lagështirën në rrugë dhe shpejtësinë, ndërsa grupi hetimor po punon për të zbardhur rrethanat e plota të aksidentit.

Një natë që për Laertin dhe familjen e tij duhej të ishte si çdo natë tjetër, u kthye në një tragjedi të pakthyeshme.

Ngushëllime familjes, të afërmve dhe miqve të Laertit.

**FACT CHECK:** Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e raportoni këtu.

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR



Më të Lexuarat

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.